



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



Nr. i Protokollit: 02-24

Shtime, më 22 janar 2024

## PLANI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2024

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), është organ këshilldhënës i themeluar me udhëzimin administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. KKSB-ja në bashkëpunim me Policinë, analizojnë dhe shqyrtojnë të gjitha çështjet e sigurisë së komunitetit për të mirën e të gjithë qytetarëve që jetojnë në komunë.

Qëllimi i KKSB-së është ngritja e vetëdijes kundër llojeve të ndryshme të krimit, kundër prishjes së rendit dhe sjelljeve të dhunshme brenda komunitetit lokal si dhe identifikimi i shqetësimeve lokale sa i përket sigurisë publike. Pra, qëllimi i KKSB-së nënkupton krijimin e ambientit për implementimin e një koncepti të ri të sigurisë në bashkësi ku jetojmë, duke mundësuar që institucionet e sigurisë të hyjnë në partneritet me qytetarët e komunës në mënyrë që të evidentohen rastet dhe të ndërmerren masa preventive në parandalimin e tyre.

Sipas udhëzimit administrativ të cekur më lartë, çdo vit duhet të hartohet Plani i Punës së KKSB-së. Qëllimi i Planit të Veprimit për Siguri në Bashkësi është koordinimi efikas i punës dhe aktiviteteve të institucioneve bashkë me qytetarët për të ndërtuar një shoqëri e cila jeton në paqe dhe pa kërcënime nga rreziqet që prekin sigurinë publike personale dhe të pronës duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e Komunës së Shtimes, si një vend i qetë dhe me standarde të larta të sigurisë.

Plani Vjetor i Punës së KKSB-së, përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan synon që të identifikoj qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësive për kryerjen e detyrave të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për KKSB-në.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara me këtë plan, por do të jetë aktiv edhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme dhe trajtimin e kërkesave të tyre të kësaj natyre.

KKSB do të zhvilloj raporte të rregullta me Kuvendin e Komunës, që kjo e fundit, pra legjislativi komunal të mbështesë funksionimin e KKSB-së dhe të përkrahë nismat dhe projektet konkrete në dobi të sigurisë së përgjithshme për qytetarët.

Nr.	Çështjet për shqyrtim	Bartësit	Bashkëpunimi	Afati kohor për zbatimin
1.	Angazhimi në parandalimin e dukurive negative në shkolla përmes mekanizmave të kontrollit në shkollë	Drejtoria e Arsimit	Policia e Kosovës; Këshilli i Prindërve; Këshillet e Nxënësve	Gjatë tërë vitit shkollor
2.	Siguria ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore dhe të tjera)	Inspektorati i Komunës	Policia e Kosovës	Gjatë tërë vitit
3.	Parandalimi i aksidenteve në trafik	Policia e Kosovës	Komuna e Shtimes	Gjatë tërë vitit
4.	Luftimi i narkomanisë në shkolla dhe hapësira publike	Policia e Kosovës	Komuna e Shtimes	Gjatë tërë vitit shkollor
5.	Kontrolli dhe trajtimi i lëmshkërkuesve	Policia e Kosovës	Komuna e Shtimes	Gjatë tërë vitit
6.	Pengimi dhe parandalimi i dhunës në familje	Policia e Kosovës	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Punë Sociale, Mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje	Gjatë tërë vitit
7.	Pengimi dhe parandalimi i vetëvrasjeve	Policia e Kosovës	Qendra për Punë Sociale	Gjatë tërë vitit
8.	Parandalimi i vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda	Policia e Kosovës		Gjatë tërë vitit
9.	Masat kundër ndotjes akustike (zhurmës)	Inspektorati i Komunës	Policia e Kosovës	Sezoni veror
10.	Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave	Drejtoria e Shërbimeve Publike /Ndërmarrja Publike "Pastëria"		Gjatë tërë vitit
11.	Masat për trajtimin e qenve endacak	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural		Gjatë tërë vitit
12.	Pengimi i zjarreve fushore dhe malore	Drejtoria e Shërbimeve Publike -Njësia e Zjarrfikësve	Policia e Kosovës	Sezoni veror

13.	Zbatimi i masave për sigurinë në punë	Inspektorati i Komunës Drejtoria e Urbanizmit, Mjedisit dhe Kadastrit		Gjatë tërë vitit
14.	Kontrolli, shpërndarja dhe ndalesa për mjetet piroteknike	Inspektorati i Komunës		Sezoni dimëror
15.	Pengimi i armëmbajtjes pa leje	Policia e Kosovës		Gjatë tërë vitit
16.	Koordinimi dhe masat në pengimin e prirjeve ekstremiste fetare që shpien në terrorizëm	Policia e Kosovës	Kleri fetar Komuna e Shtimes	Gjatë tërë vitit
17.	Riintegrimi i personave të riatdhesuar	Komuna e Shtimes		Gjatë tërë vitit
18.	Aktivitetet e parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore	Policia e Kosovës	Inspektorati i Komunës	Gjatë tërë vitit
19.	Kontrolli i shpërndarjes/shitjes së produkteve për personat nën 18 vjeç	Inspektorati i Komunës	Policia e Kosovës	Gjatë tërë vitit
20.	Hapja e kanaleve kulluese si masë për shmangien e vërshimeve	Drejtoria e Shërbimeve Publike		Gjatë tërë vitit
21.	Shtirja e rrjetit të ndriçimit publik në lagjet e fshatrave dhe qytetit	Drejtoria e Shërbimeve Publike		Gjatë tërë vitit
22.	Masat për krijimin e vendparkingjeve të reja dhe racionalizimi i shfrytëzimit të vendparkingjeve aktuale	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Policia e Kosovës Inspektorati i Komunës	Gjatë tërë vitit
23.	Vendosja e sinjalistikës rrugore përgjatë gjithë territorit të Shtimes	Drejtoria e Shërbimeve Publike		Gjatë tërë vitit
24.	Masat për mirëmbajtjen e rrugëve dhe rrugicave të dëmtuara	Drejtoria e Urbanizmit, Mjedisit dhe Kadastrit	Policia e Kosovës	Gjatë tërë vitit
25.	Shtimi i kamerave të sigurisë në qytetin e Shtimes, lagje dhe në rrugët kryesore të fshatrave	Drejtoria e Shërbimeve Publike		Gjatë tërë vitit
26.	Eliminimi i furrave të gëlqeres	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Policia e Kosovës Inspektorati i Komunës	Gjatë tërë vitit

Kryesuesi i KKSB-së,

Qemajl Aliu

